



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.829/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Dren Rogova, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Tonex” shpk, me numër unik identifikues 810159089 me seli ne rr.”Ramiz Cernica” pn, Komuna e Gjilanit, te cilin e përfaqëson sipas autorizimit Donat Huruglica avokat ne Gjilan, ndaj debitorit “P&I” shpk, me numër unik identifikues 811288390, me seli ne fshatin Elezaj Komuna e Kaçanikut, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2216/23 dt.05.02.2024, me datën 29.11.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e debitorit “P&I” shpk, me numër unik identifikues 811288390, me seli ne fshatin Elezaj Komuna e Kaçanikut, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale –Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2216/23 dt.05.02.2024, Vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës–Dhomat e Shkalles se Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2216/23 dt.24.01.2024, e ka refuzuar si te pabazuar propësimin e debitorit “P&I” shpk, me numër unik identifikues 811288390, me seli ne fshatin Elezaj Komuna e Kaçanikut ndërsa urdhrin përmbarimor P.769/23 dt.13.11.2023, te lejuar nga Përmbaruesi Privat Kushtrim M. Musa Gjilan, e ka lenë ne fuqi.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit ligjor, ka paraqitur ankesë debitori, për shkak te shkeljes se dispozitave te LPP dhe LPK, dhe konstatimit te gabuar te gjendjes faktike, me propozim qe gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj këtë ankesë si te bazuar, aktvendimin e atakuar ta prish dhe çështjen ta kthej ne rigjykim dhe rivendosje ne shkalle te parë.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Tonex” shpk, me numër unik identifikues 810159089 me seli ne rr.”Ramiz Cernica” pn, Komuna e Gjilanit, me datën 13.11.2023, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit “P&I” shpk, me numër unik identifikues 811288390, me seli ne fshatin Elezaj Komuna e Kaçanikut, sipas dokumentit te besueshëm - Faturës nr.2023-38 dt.03.10.2023. Përmbartuesi Privat Kushtrim M. Musa Gjilan, duke vepruar sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.769/22 dt.13.11.2023, ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër te borxhit qe rrjedh nga fatura t’i paguaj shumën prej 8001.90 euro, me kamatë prej 8% ligjore si dhe shpenzimet tjera te procedurës.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori, me datën 01.12.2023 ka paraqitur prapësim, në të cilin e ka theksuar se produktet/materialet të cilat janë objekt i faturës në këtë procedurë përmbartimore, nuk janë pranuar asnjëherë nga ana e debitorit, duke shtuar se kjo situatë është shfrytëzuar në keqbesim nga ana e kreditorit pasi që debitori ka pranuar faturën mirëpo asnjëherë nuk ka pranuar produktet, i referohet nenit 260 ppar.1 te LPP dhe nenit 71 par.1 pika 1.7 dhe 1.8 e LPP dhe propozon qe gjykata ta aprovoj si të bazuar prapësimin e debitorit dhe të refuzoj propozimin për përmbartim si dhe t’i paguhen shpenzimet e procedurës të cilat nuk i ka specifikuar.

Nga shkresat ne lëndë rezulton se kreditori nuk ka ushtruar përgjigje në prapësim.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkalles se Parë, pas vlerësimit të prapësimin dhe provave ne lende, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.2216/23 dt.05.02.2024, me të cilin ka vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata vlerëson se fatura në bazë të cilës është lejuar urdhri për përmbartim, i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 par.3 te LPP i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”* dhe nenin 37 të LPP-së i cili parasheh qe *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*. Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm përkatësisht Faturën nr. F-2023-38 të datës 03.10.2023, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sepse ne të janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i kësaj fature, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, e njëjta është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt gjë qe vërtetohet nga vula dhe nënshkrimi i debitorit, duke vendosur kështu si ne dispozitiv te aktvendimit.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka refuzuar si te pabazuar prapësimin e debitorit dhe ka lënë ne fuqi urdhrin përmbartimor.

Gjykata e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim ne pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës se dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve edhe kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar. Konsideron se fatura nr.2023-38 dt.03.10.2023 mbi bazën e te cilës është lejuar

përmbarimi plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm konform nenit 29 par.3 të LPP i cili përcakton se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*“ dhe nenit 37 të LPP-së ti cili parasheh që “*kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit ti bashkëngjitet dokumenti i tillë në origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*”, e që në rastin konkret rezulton se kjo faturë si e tillë është e përshtatshme për përmbarim, sepse është e nënshkruar dhe e vulosur nga debitori ashtu që konsiderohet se është pranuar në mënyrë të rregullt nga i njëjti ndërsa propozimit për përmbarim i është bashkëngjitur në origjinal.

Kjo gjykatë i analizoi pretendimet e debitorit se kreditori nuk ia kishte dorëzuar asnjëherë debitorit materialet që janë objekt i faturës lëndore dhe meqë nuk është përmbushur ky kusht kryesor nga kreditori atëherë konsideron se kredia është shuar, mirëpo vlerëson se këto pretendime nuk hynë në domenin e procedurës përmbarimore sepse në këtë procedurë konform parimit të rigorozitetit formal vlerësohen vetëm elementet formale të dokumentit mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi dhe jo rrethana tjera, për çka në lidhje me këto pretendime sugjeron palën debitore të drejtohet në procedura tjera siç është ajo konetstimore. Po ashtu kjo gjykatë analizoi edhe pretendimet tjera ankimore të debitorit por i vlerësoj si jo relevante për një vendosje ndryshe ashtu që i refuzoi ndërsa aktvendimin e atakuar e vërtetoj.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkalles së Dytë
K.DH.SH.II.nr.829/24, datë 29.11.2024

Gjyqtari,
Dren Rogova